



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

Nr. i Protokollit: 02/ 679
24/06/2025

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Zborc

E martë, më 10 qershor 2025

Kohëzgjatja e takimit: 17:45-19:10

Vendi i takimit: SHF "Abdullah Shabani"

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryetari i Komunës – z.Qemajl Aliu, Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i Drejtorisë Për Shërbime Publike – Bardhyl Rushiti, Drejtori i Drejtorisë për, Drejtoresha e Drejtorisë për Shëndetësis – Mimoza Salihu si dhe Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi – Grejtalb Emini.

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028

Kryetari i Komunës z.Qemajl Aliu: Përshëndetje për te gjithë dhe faleminderit shumë që keni nda kohën me ju përgjigj ftesës sonë publike për një takim i cili është i përvitshëm.

Siç e dini është hera e katërt në këtë detyrë që vijm si qeverisje, rregullat janë të tilla që buxheti i komunës aprovohet çdo vit edhe kjo është ajo që quhet korniza e parë buxhetore.

Buxheti i Komunës së Shtime këtë vit është rreth 11 milion euro, ku prej atyre 11 milion diku rreth gati 2.5 milion euro janë investime kapitale dhe të tjerat janë në dikastere tjera siç janë: mallra dhe shërbime, subvencione edhe paga e mëditje.

Tani buxhetin, sidomos tek investimet kapitale ne e ndajmë në mënyr të barabart dhe në mënyrë proporcional, 22 vendbanime janë së bashku me qytetin në komunën e Shtimes dhe ne siç e dini për çdo vit në raport me numrin e popullësis, këto projekte jemi munduar t'i ndajm në të gjithë territorin pa dallime, në mënyr që ne të plotësojm një kriter që ne e kemi vënë qysh në krye të rradhës, barazinë dhe drejtësin.

Për hirë të së vërtetës dhe për fatin tonë të mirë ka qëlluar që përveç buxhetit komunal, ne kësaj radhe si Shtime e kemi pasur edhe mbështetjen e fuqishme, direkte nga qeveria e Kosovës.

Të gjitha këto investime të cilat po ndodhin gjithandej teritorit të Komunës së Shtimes, pa mbështetjen qeveritare nuk do të ishin të mundura, pasi që ju po e shihni edhe vet që me 2.5 milion euro të investimeve kapitale neve na ishte dasht të presim sa vite që ato investime të mëdha të realizoheshin. Kështu që ne jemi mirënjohës për mbështetjen qeveritare që e kemi, normal kjo punë nuk ka ardhur vetë, ka ardhur më angazhimet e tona, përpjekjet e tona, me trokitjet në dyert,

me avokim që t'i sjellim në Komunën e Shtimes dhe jemi krenar dhe të kënaqur që po kemi mundësi që besimin të cilin na e keni dhënë të u'a kthejm në punë të mira dhe në vepra të mëdha. Të kthehemi te buxheti komunal, ne sot do t'i marrim kërkesat, duke shpresuar që socila lagje e ka përfaqësuesin e vetë, në mënyr që këto kërkesa të hynë në kornizën buxhetore, të votohen në shtator edhe të projektohen dhe të implementohen në pranverën e vitit të ardhshëm.

Janë bërë kogjo shumë punës, asnjëherë nuk është mjaftueshëm, asnjëherë nuk është boll që të punohet, megjithatë po shpresoj që me besimin e juaj me mbështetjen e juaj edhe të tjera do të bëhen.

Qëllimi i këtij takimi është, kërkesat të cilat burojnë direkt nga qytetarët.

Po ashtu mos të harroj të përmend që sot jam këtu së bashku me Kryesuesin, Adnan Ademi, Drejtoreshën e Shëndetësis, Mimoza Salihun, Drejtorin e Infrastrukturës dhe Urbanizmit, Grejtalb Eminin, Drejtorin e Shërbimeve Publike, Bardhyl Rushitin si dhe me Gentiana Mehmetin asistente në kabinetin tonë.

Unë tani ua kisha kaluar fjalën juve që t'i bëni kërkesat e juaja.

Kërkesat e banorëve të fshatit :

- **Ismet Sadiku:** Rregullimi i shkollës, të rregullohen dyert, banjot me një fjalë e gjithë shkolla. Sidomos është e rëndësishme të rregullohen banjot.
Trotuari nga shkolla deri tek lagjia e Badragjive, pasi që është shumë i nevojshme për fëmijët.
Ndriqim te lagjia e Gjinofove.
Rruga Zborc-Carralevë (te gurët e verdh), rruga është e pakalueshme, nëse mund të bëhet një ndërhyrje.
Po ashtu edhe një pyetje salla e sportit kur pritët të përfundoj?
- **Mehdi Dauti:** Duhet të bëhet një intervenim te fusha në Zborc, të bëhet një muri mbrojtës. Kemi probleme me rrymë, është shumë e dobët.
Në lagjen e Gjinofove ndriçimi është i nevojshëm.
Po ashtu urgjente është që të rregullohet shkolla.
Te lagjia e Topillëve ka nevojë për trotuar.
Janë disa rrugë të cilat duhet të rregullohen, janë rrugë të cilat të dërgojn te varrezat e disa dëshmorëve, së pagu të rregullohen me zhavor.
Si fshat është mirë që të bëhet një kullë ose ndonjë përmendore për dëshmorët.
- **Idriz Mehmeti:** Të bëhen dy pengesa, njëra të fillim ë rrugës kryesore dhe tjetra ne fund. Të largohen barishtet nga rruga kryesore pasi që është ngushtuar rruga, është mirë të bëhet një krasitje e pemëve.
Të bëhet ndriçimi te lagjia e "Badragjive"
Të vendoset një pasqyrë te rruga kryesore.
- **Salih Nuredini:** Te shtëpia e të pamës të rregullohet përpara me asfalt ose kocka.
- **Selman Kadrija:** Ndriçim dhe trotuar në lagjen e Badragjive. Të bëhet një park apo një fushë e sportit në lagjen tonë. Të shtrohen disa rrugë të arave.
4-5 në lagjen tonë po ashtu kanë nevojë për kanalizim

- **Besmir Kadrija:** Përshëndetje për të gjithë unë jam Besmir Kadrija, dhe me profesion jam arkitekt vijë nga lagjia e Gjinofove dhe po ashtu jam pro të gjitha kërkesave të cilat janë bërë deri tani nga banorët para meje, disa prej tyre kanë qenë dhe pjesë e listës së kërkesave të cilat unë i kam bërë. Një e mirë të cilën po e vrej këtu në këtë tubim është se secili ka ardhur këtu me një klërkesë për interes publik domethënë për një interes të përgjithshëm dhe kjo besoj që është në të mirë dhe në favor të fshatit. Iniciativën të cilën e tha baci Idriz për pastrimin e rrugës kryesore, largimi apo prerja e pemëve dhe barnishteve është një kërkesë shumë me ven, për shkak se tasht është ngushtuar ekstrem shumë rruga kryesore nga gjelbrimi pasi që është koha e verës, po ashtu do të ishte mirë që ajo pjesë të bëhet me një trotuar pasi që banorët e shfrytëzojnë edhe si lloj shëtitore. Një detaj i cili nuk u cek është siguria, pasi që tani rrugët e reja të cilat janë bërë, kanë krijuar dhe lidhje të reja me Pjetërshicën, aty është filluar edhe një deponi ilegale e mbeturinave e cila është ekstrem e rrezikshme, përveç kësaj vozitjet pa patent shofer janë ekstrem të mëdhaja, mua personalisht më është thyer një pasqyre nga dikush që nuk e di as kush është, kta si kërkesë e kisha shtruar që policia të paktën një herë një javë, në orare të ndryshe, ta bëjnë një kontrollë për çështje të sigurisë së lagjes, çoftç ditën apo natën. Do të ishte mirë të bëhej edhe mirëmbajtja e asaj rrugë.

Kërkesa tjetër është te ndriçimi për lagjen tonë, në pjesën e rrugës kryesore, kërkesa është bërë me 27 mars, kjo është një kërkesë të cilën nëse është e mundshme të bëhet sa më shpejt, për rrugën kryesore "Sokol Dauti". Ndërsa tek pjesa e fushës së sportit e cila është e ndërtuar tek lagjia e "Gjinofove", është një kërkesë tepër urgjente e cila ndoshta nuk është zgjidhja ideale të mbushet me dhe për të nxënë hapsirën, po të paktën të bëhet një rrethojë metali një metër lartësi e cila do t'i siguronte fëmijët, sepse frekuentimi i atij parku nga fëmijët është ekstrem i madh, e kjo që është e mirë se ardhur për atë investim që e keni bërë ju, mirëpo pjesa e asaj fushe duhet të rregullohet që të paktën të mënjanohej rreziqet për fëmijët. Në këtë aspekt edhe unë mund të ju ndihmoj me ndonjë ide se si të bëhet zgjidhja më e mirë për atë pjesë.

Te Xhamia është mirë që të rregullohet një pjesë me asfalt, aty po ashtu mund të vendosim edhe disa ulse që të mund të shfrytëzohet nga banorët.

Një tjetër kërkesë apo pyetje është edhe mjesa e bërlllogut në rasadnik, a ka ndonjë plan që të bëhet një pastrim më afat gjatë ? Apo pse jo ju së bashku me ne të bëjmë një organizim për pastrimin e asaj pjese.

Shkolla po ashtu ka nevojë për renovim.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti






REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në: Zbore
Date: 10/10/2025

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	NUJAZI MEHMETI	
2	KEVZI SALIHU	
3	FADIL KHAMAZI	
4	XHAKIR NUREDINI	
5	Gresa Bislimi	
6	Idriz Mehmeti	
7	SALIH NURDINI	
8	Haki Kurtishi	
9	Shaban Bislimi	
10	Getuad Kadrija	
11	Fatlum Kadrija	
12	Besmir Kadrija	
13	MEHDI DAVTI	
14	Khmeri Xhamazli	
15	Ismet Szoliku	
16	Sekman, Kadrija	
17	Ahmet Mehmeti	

18	Anita Kurti	
19	ARTIN BISHIMI	
20	DEUT DUTI	
21		
22		
23		
24		
25		
26		
27		
28		
29		
30		
31		
32		
33		
34		
35		
36		
37		
38		
39		
40		
41		